

Debat rreth perspektivës së Kosovës për t'u inkuadruar në procesin e liberalizimit të vizave në BE

“BE-ja nuk do ta lejojë izolimin e Kosovës”

“Bashkimi Evropian (BE) po kërkon mënyra për përfshirjen e Kosovës në procesin e liberalizimit të vizave, me qëllim që të mos e lejojë izolimin e saj”, ka thënë ambasadorja çeke, Hrebickova. Ndërkaq ministri Pajaziti shpreston se deri në fund të vitit të ardhshëm do të përmbushen kriteret për këtë proces

KOHA

LUMTURIE BLAKAJ

PRISHTINË, 22 QERSHOR - Përfaqësuesit e pranishëm ndërkombëtarë në Kosovë edhe një herë kanë shprehur zotimin e tyre se Bashkimi Evropian (BE) është i përkushtuar në gjetjen e mënyrave që edhe Kosova të jetë pjesë e procesit të liberalizimit të vizave, dhe se nuk do të lejojë izolimin e saj. Këto deklarime janë bërë të hënën në debatin për perspektivën e Kosovës për t'u inkuadruar në procesin e liberalizimit të vizave në BE, të organizuar nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) në bashkëpunim me Iniciativën Kosovare për Stabilitet (IKS). Zyrtarët ndërkombëtarë dhe ata vendorë pohuan se Kosova është pjesë e Bashkimit Evropian (BE) dhe se ka perspektivë evropiane, por sipas të pranishmëve në debat ende ka kohë për të përmbushur disa kriteret rreth liberalizimit të vizave me vendet e BE-së. Ambasadorja e Çekisë, Janina Hrebickova, vendi i së cilës e ka kryesimin radhës së Bashkimit Evropian (BE), ka thënë se përmbushja e kriterëve për liberalizim e vizave varet edhe nga përkushtimi i Qeverisë së Kosovës. Sipas saj, Bashkimi Evropian (BE) po kërkon mënyra për ta përfshirë Kosovën në procesin e liberalizimit të vizave, si dhe të mos lejojë izolimin e Kosovës.

“Presidenca evropiane e Çekisë e ka saktësuar shumë herë se Kosova nuk duhet të lihet anash



Komisioni Evropian do të gjejë një masë të vetme për të lehtësuar udhëtimin për njerëzit e Kosovës dhe për të filluar procesin me mbështetjen politike të të gjitha 27 vendeve anëtare të BE-së”, ka theksuar ambasadorja Janina Hrebickova, e cila u zotua se Kosova nuk do të lihet anash në procesin e liberalizimit të vizave. Por, sipas ambasadores çeke janë institucionet e Kosovës që duhet t'i përmbushin kriteret për liberalizimin e vizave, ndërkaq nuk mohoi se përveç kriterëve teknike për çështje të caktuara mund të ketë edhe ndikime politike. Hrebickova ka deklaruar se Çekisë i janë dashur tetë vjet deri në përmbushjen e kriterëve për regjim pa viza, mirëpo sipas saj në rastin e Kosovës duhet gjetur

problem, kur kihet parasysh se ende nuk e kanë njohur të gjitha shtetet anëtare të Bashkimit Evropian (BE). “Problematike mbetet njohja e Kosovës nga disa shtete të BE-së, që numerikisht nuk janë shumë, por që paraqesin pengesë në procesin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës”, ka thënë ai. Sipas ministrit Pajaziti, institucionet e Kosovës e kanë nisur hartimin e një plani të veprimit për çështjen e liberalizimit të vizave, duke u bazuar në praktikën e vendeve fqinje dhe në konsultim me partnerët ndërkombëtarë. “Qeveria e Republikës së Kosovës ka vendosur të bëjë një plan të vetin dhe udhërrëfyes për çështjen e liberalizimit të vizave, duke u bazuar në praktikën e vendeve fqinje dhe në

imin e vizave, kur kihet parasysh se vendi ynë teknikisht nuk është larg vendeve të rajonit në këtë proces. Ai nuk e ka përjashtuar mundësinë që në prag të zgjedhjeve lokale mund të ketë deformime të trajtimit të çështjes së liberalizimit të vizave. Sipas tij, nuk është vetëm çështja e pasaportave biometrike që mundëson liberalizimin e vizave, por janë një sërë kushtet politike dhe ekonomike që duhet t'i plotësojë Kosova. Ministri theksoi se, duke parë nivelin e zhvillimit të deritashëm ekonomik edhe përkundër përpjekjeve të mëdha, Kosova e ka të pamundur t'i ndalojë tani qytetarët e saj që të dalin jashtë vendit për të kërkuar punë në Evropë. Ministri Zenun Pajaziti ka kërkuar që të hyhet në partneritet me vendet e BE-së, sepse ai shfaqti besimin se kjo është forma më e mirë që migrimi ilegal gradualisht të kthehet në legal dhe të mos ketë probleme siç janë këto të tanishmet. Ndër të tjera, ministri ka përmendur se menaxhimi i integruar i kufijve dhe sundimi i ligjit janë kriteret kryesore që Kosova duhet t'i plotësojë për të qenë pjesë e procesit të liberalizimit të vizave. Ndërsa Verena Knaus nga Iniciativa Evropiane për Stabilitet (ESI) ka thënë se perspektiva dhe udhëtimi i lirshëm pa viza në Evropë ka qenë një nga dëshirat e qytetarëve dhe e të gjitha qeverive të shteteve të rajonit. Ajo ka vlerësuar se

një hartë e qartë për rrugën të cilën ajo duhet ta ndjekë”, ka thënë Knaus. Sipas saj, kjo formë do të ishte zgjidhja më e mirë, ngase edhe do të reduktoheshin kërkesat e kosovarëve për t'u pajisur me pasaporta serbe. Ajo ka pohuar se mosnjohja e shtetit të Kosovës nga 5 vende të BE-së bën që Komisioni Evropian t'i ketë duart e lidhura sa i përket çështjes së liberalizimit të vizave për Kosovën, edhe pse me dyer të mbyllura është duke u punuar në këtë drejtim.

Knaus ka përmendur se bisedimet për liberalizimin e vizave me Serbinë kanë filluar qysh në fillim të 2008-s si lloj “stimulimi” në kohën kur pritej pavarësimi i Kosovës, ndërkaq Maqedonia dhe Mali i Zi pritet të jenë ndër vendet të cilat do të përfshihen në këtë proces, kurse Kosova, Shqipëria, Bosnjë-Hercegovina ende janë jashtë përfshirjes së procesit për liberalizim e vizave. Nga ana e saj, Engjellushe Morina, drejtore e Iniciativës Kosovare për Stabilitet (IKS), u shpreh skeptike për procesin e liberalizimit të vizave, kur kihet parasysh se qytetarët e Kosovës nuk mund të lëvizin lirshëm. “Përveç procedurave për viza, shpeshherë nuk jepen arsye të refuzimit të tyre”, ka thënë Morina, e cila e ka quajtur të pajustificueshme moskthimin e shpenzimeve në momentin e refuzimit të vizës. Pjesëmarrësit, ndërkaq, thanë se

izolimim e Kosovës.
 "Presidenca evropiane e Çekisë e ka saktësuar shumë herë se Kosova nuk duhet të libet anash. Andaj mund t'iu siguroj se Bashkimi Evropian (BE) është i përkushtuar që të mos lejojë një izolim të tillë, jo për shkak të Kosovës, sigurisë në rajon dhe çështjeve të migrimit, por për shkak të vlerave të Bashkimit Evropian, sipas të cilave është themeluar BE-ja. Duhet të kuptojmë perspektivën evropiane të Kosovës", ka thënë ambasadorja Hrebickova. Ajo ka pohuar se po punohet edhe me vendet që nuk e kanë njohur Kosovën, që të jenë më aktive në procesin e afrimit të Kosovës me BE-në. "Shtetet anëtare të BE-së po e mbështesin këtë proces dhe kam shpresë se

Çekisë i janë dashur të tre vjet dhe në përmbushjen e kriterëve për regjim pa viza, mirëpo sipas saj në rastin e Kosovës duhet gjetur mënyra të tjera nga marrëveshjet klasike për të mos e lënë jashtë procesit. Nga ana tjetër, ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Zenun Pajaziti, shprehu mendimin se çështja e liberalizimit të vizave vazhdon të mbetet

pa viza në Evropë ka qenë një nga dëshirat e qytetarëve dhe e të gjitha qeverive të shteteve të rajonit. Ajo ka vlerësuar se Kosovës duhet t'i ofrohet një rrugë e qartë në këtë proces, në mënyrë që kosovarët të mos stimulohen në marrjen e pasaportave të Serbisë, shtet ky që pritet të përfshihet në liberalizimin e vizave. "Kosovës duhet t'i jepet

thimin e shpenzimeve në momentin e refuzimit të vizës. Pjesëmarrësit, ndërkaq, thanë se Kosova nuk do të jetë kurrë geto e vizave. Disa vende të rajonit tashmë kanë nënshkruar marrëveshje për liberalizimin e vizave me BE-në, kurse i vetmi vend nga të gjitha shtetet fqinje që nuk është përfshirë në këtë proces është Kosova.

Shtrimi i rrugës me zhavorr tensionon "Kroi e Vitakut"

Komandanti i Stacionit policor në veri të Mitrovicës, Milija Milosheviq, ka thënë se ndërhyrja e shpejtë e Policisë së Kosovës e ka evituar incidentin që ka mundur të jetë më i madh

KOHA
 11/11/05

IZEDIN KRASNIQI

MITROVICË, 22 QERSHOR - Shtuarja e një rruge me zhavorr në lagjen "Kroi i Vitakut" në veri të Mitrovicës, të hënën pasdite, për një kohë e ka tensionuar situatën e sigurisë pasi një grup i serbëve kanë protestuar.

Në zonën ku po bëhet rindërtimi i shtëpive të shqiptarëve është tensionuar situata rreth orës 14:30 minuta, kur një grup prej rreth 20 serbëve kanë bërë përpjekje për të ndërprerë punët e shqiptarëve për shtuarjen e rrugës me zhavorr. Rasim Veseli, drejtor i Drejtorisë për Shërbime Publike dhe Infrastrukturë në Komunën e Mitrovicës, ka deklaruar se meqë gjatë natës kishte rënë shi qarkullimi i automjeteve të rënda nëpër rrugën e zonës ku po punohet në rindërtimin e shtëpive shqiptare ishte vështirësuar shumë, andaj edhe u vendos që rruga të shtrohet me zhavorr, që e kishte grumbulluar KFOR-i afër shtëpisë së Ali Kadriut.


Posa serbët kanë vërejtur se

rruga po shtrohet me zhavorr, rreth 20 sish, kryesisht të rinj, janë tubuar dhe kanë ardhur për të kërkuar që punët të ndërpriten, por kjo kërkesë e tyre nuk është marrë parasysh. Pas kësaj ata kanë filluar të gjuajnë me gurë dhe me këtë rast kanë qëlluar një polic të Kosovës, të përkatësisë boshnjake, por fatmirësisht nuk i kanë shkaktuar lëndime të rënda.

Ky incident, sipas zyrtarëve komunalë, po bëhet që të pengohet faza e dytë e procesit të rindërtimit të shtëpive shqiptare, që përfshin rindërtimin afër shtëpive të serbëve.

Përfaqësuesi i lagjes "Kroi i Vitakut", Musa Haliti, ka pohuar se grupi i serbëve kishin kërkuar që ata t'i ndërprisnin punët dhe të shkonin të punonin, si kishin thënë ata, në Bajgorë.

Komandanti i Stacionit policor në veri të Mitrovicës, Milija Milosheviq, ka thënë se ndërhyrja e shpejtë e Policisë së Kosovës e ka evituar incidentin që ka mundur



të jetë më i madh. "Gjatë gjithë kohës e kishim situatën nën kontroll. Unë u thashë serbëve që të largohen nga vendi ku ishin tubuar, duke iu premtuar se shqiptarët nuk do të punojnë

më në brendi të rrugës pa ndonjë marrëveshje", tha Milosheviq. Gjendja është qetësuar pas orës 16:00, kur serbët janë larguar, ndërsa ka vazhduar shtuarja e rrugës me zhavorr.

Fluturoni direkt me

CROATIA AIRLINES

Prishtinë - Zagreb

dhe shumë destinime tjera Europiane

Prej 20 Qershorit me
 më shumë fluturime

5

herë në javë

Përfitonit prej çmimeve të lira dhe
 shërbimit profesional

CROATIA AIRLINES / AltaVia Travel

Rr. Luan Haradinaj #27,
 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel. 038 233 833 në qytet ose

Tel. 038 594 111 në aeroport

Email. croatia@altaviatravel.com

www.altaviatravel.com